MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË KOMUNËN BRADASHESH, ELBASAN

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Komunën Bradashesh, Elbasan me objekt: : "Mbi Vlerësimin e aktivitetit ekonomiko-financiar, zbatimin e Planit Rregullues të Përgjithshëm, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike e lejeve të ndërtimit, lejeve te shfrytëzimit, administrimit të aseteve, vlerësimit për shitje të trojeve nën objekt, shitjen e trojeve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, funksionimi i policisë të komunës"dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr.77 , datë 21. 05.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 144/5, datë 21.05.2012, dërguar **z. Sabri Sallaku,** Kryetar i komunës, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

I- Për Zyrën e Tatim Taksave.

1. Të marrë masa:

-për realizimin dhe rritjen e të ardhurave vendore si dhe për planifikimin e saktë të disa taksave vendore të cilat kanë rezultuar me rezerva, si taksa e pastrimit familjar etj.

-për auditimin në terren ndaj subjekteve fizike që vetë deklarojnë xhiro vjetore minimale dhe për auditimin e subjekteve që nuk janë verifikuar asnjëherë si dhe atyre që kanë ngarkesë të njëjtë për çdo vit.

-për kompletimin e dosjeve me dokumentacionin e duhur sidomos me dokumentin e hipotekës për efekt të llogaritjes taksës së ndërtesës.

Menjëherë

2. Nga ana e Policisë së Komunës në bashkëpunim me Zyrën e Taksave Vendore të hartohet paketa me llojet dhe masën e gjobës dhe t'i kërkohet Këshillit Komunës, të vendosë për çdo shkelje të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative, siç përcaktohet në shkronjën (a) të ligjit nr. 10.279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", neni 6, "Shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative".

Menjëherë

3. Të rakordojë me Policinë e Komunës, për të marrë masa për vjeljen e vlerës 14,025,648 lekë , bazuar në ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" ndryshuar me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 neni 49 "Shkeljet dhe dënimet për regjistrimin", pika 1, dhe në zbatim të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997, ndryshuar me ligjin nr. 8335, datë 23.04.1998 dhe me pikat 3 e 5 të udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë të Pushtetit Vendor nr. 5, datë 27.01.2003, prej të cilave:

- Në 29 raste, nga biznesi i vogël që s'kanë paguar detyrimet e taksave vendore , në vlerë 1,245,708 lekë
- Në 19 raste, nga biznesi i madh, që s'kanë paguar detyrimet e taksave vendore, në vlerë 11,066,140 lekë
- Për 743 familje, nuk kanë likuiduar taksën e tokës bujqësore me vlerë 625,800 lekë
- Për 680 familje, nuk kanë likuiduar taksën e ndërtesës me vlerë 408,000 lekë,
- Për 680 familje, nuk kanë likuiduar taksën e pastrimit me vlerë 680,000 lekë.

(*sipas listës bashkëlidhur)*.
-Të bashkëpunojë me Zyrën e Financës për kontabilizimin e debitorëve nga bizneset që nuk kanë shlyer detyrimet.

Menjëherë

II. Për Zyrën e Financës.
1. Të marrë masa në zbatim të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 "Për inventarizimin e pasurisë paluajtshme shtetërore dhe transformimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore" dhe UKM nr 3, datë 18.07.2002 dalë në zbatim të tij, për të regjistruar në ZVRPP, objektet ndërtimore që aktualisht janë të pa regjistruar, dhe nuk kanë certifikatë pronësie.

Menjëherë

2. Të kërkohet nga firma e ndërtimit [redacted]. të bëj riparimin e defekteve të konstatuara, në tenderin "Rikonstruksion i Rrugës Vidhishtë – Drizë, ne vlerën 525,000 lekë e cila është brenda garancisë të punimeve, në të kundërt të zbatohen sanksionet e kontratës nr. 105/11 datë 01.07.2009. (mbi garancinë e punimeve).

Menjëherë

B. <u>MASA PËR SHPËRBLIM DËMI</u>

Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit në vlerën ***1,977,254 lekë***, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe shkallët e gjykimit, përkatësisht:

1. Vlera 72,192 lekë, nga [redacted], për përfitim page më tepër, në kundërshtim me pikën 1, lidhja nr. 1 klasa e IX-të, të VKM 717 datë 23.6.2009, "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore".

Menjëherë

2. Vlera 223,549 lekë, nga ..[redacted] 151,688 lekë, [redacted].vlere 35,004 lekë dhe [redacted]. vlerë 36,857 lekë, paguar më tepër nga tarifa për kolaudim të objekteve, në kundërshtim me pikën b "Tarifat për Kolaudimin përfundimtar të Ndërtim Montimit" të VKM 444, datë 05.09.1994 "Për tarifat e Studimit, Drejtimit dhe Kolaudimit të Ndërtimit"

Menjëherë

3. Vlera 1,005,420 lekë, nga firma [redacted], për punime të pa kryera në tenderin me objekt:
-"Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugëve të brendshme, fshati Katund i Ri", Komuna Bradashesh", në kundërshtim me Kontratën Nr. 270, datë 22.07.2009, neni 8 e 11, të ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", me UKM nr. 2, datë: 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit".

Menjëherë

4. Vlera 125,693 lekë, nga firma [redacted] , për punime të pa kryera në tenderin me objekt: "Sistemim, asfaltim i rrugëve të brendshme, fshati Kusarth -Karakullak", Komuna Bradashesh", në kundërshtim me Kontratën nr. 349, datë 02.09.2009, neni 8 e 11 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", me UKM nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"

Menjëherë

5. Vlera 68,400 lekë, nga firma [redacted] për punime të pa kryera në tenderin me objekt: "Sistemim, asfaltim i rrugëve të brendshme në fshatrat Balza e Sipërme, Balza e poshtëm,

Kozan dhe Shingjon", Komuna Bradashesh, në kundërshtim me Kontratën nr. 428, datë 29.9.2010, neni 8 e 11, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, me UKM nr. 2, datë 13.05.2005, "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" .

Menjëherë

6. Vlera 482,000 lekë nga firma [redacted] për punime të pa kryera në tenderin me objekt: "Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugëve të brendshme, fshati Katund i RI (ish reparti-Harvaleas), Komuna Bradashesh", në kundërshtim me Kontratën nr. 163 datë 21.03.2011, neni 8 e 11 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, me UKM nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit".

Menjëherë

C. MASA ADMINISTRATIVE

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit" të ndryshuar, që në mbështetje të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, kreu III-të, nenet 15, 16, Komuna Bradashesh, tí propozojë Këshillit të Qarkut Elbasan, meqënëse nuk ka strukturë të INU pranë saj, të kërkojë nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik pranë Këshillit të Qarkut, dhënien e masës administrative "gjobë" për mbikëqyrësit dhe kolaudatorin e punimeve të ndërtimit për shkelje të neneve 7, 8, 11, 12, kreu I, pikat 1/2, 3, 3/1, kreu II pika 1/b, c, ç, të UKM nr. 2, datë 13.05.2005, pikën 4 të UKM nr. 3, datë 15.02.2001"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit":

1. [redacted] në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, gjobë në masën 200,000 lekë, për dëmin ekonomik shkaktuar në vlerën 1,555,820 lekë, në tenderat me objekt:

- "Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugëve të brendshme, fshati Katund i Ri".
- "Sistemim, asfaltim i rrugëve të brendshme në fshatrat Balza e Sipërme, Balza e poshtëm, Kozan dhe Shingjon".
- "Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugëve të brendshme, fshati Katund i Ri" (ish reparti – Harvaleas).

për mos kryerje të detyrës për verifikimin e zërave të punimeve të ndërtimit, ku rezultuan me diferencë në 3 tendera në kundërshtim me kontratat e punimeve me nr. reference 270, datë 22.7.2009, nr. 428, datë 29.9.2009, nr. 163, datë 21.03.2011.

2. [redacted] në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, gjobë në masën 100,000 lekë, për dëmin ekonomik shkaktuar në vlerën 125,693 lekë, në tenderin me objekt:

- "Sistemim, asfaltim i rrugëve të brendshme, fshati Kusarth – Karakullak",
- për mos kryerje të detyrës për verifikimin e zërave të punimeve të ndërtimit, ku rezultuan me diferencë në i tender në kundërshtim me kontratën e punimeve me nr. reference 349, datë 02.9.2009.

3. [redacted] në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, gjobë në masën 300,000 lekë, për dëmin ekonomik shkaktuar në vlerën 1,681,513 lekë, në tenderat me objekt :

- "Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugëve të brendshme, fshati Katund i Ri".
- "Sistemim, asfaltim i rrugëve të brendshme në fshatrat Balza e Sipërme, Balza e poshtëm, Kozan dhe Shingjon".
- "Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugëve të brendshme, fshati Katund i Ri" (ish reparti – Harvaleas).
- "Sistemim, asfaltim i rrugëve të brendshme, fshati Kusarth – Karakullak",

për mos kryerjen e detyrës për verifikimin e volumit faktik ku rezultuan me diferencë 4 tendera punimesh në kundërshtim me kontratën e punimeve 270, datë 22.7.2009, nr. 428, datë 29.9.2009, nr. 163, datë 21.03.2011 dhe nr. 349, datë 02.9.2009.

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 "Kodi i Punës"; dhe Kontratat individuale të punës, i kërkojmë Kryetarit të Komunës, që bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 8652 datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

"Vërejtje me shkrim" për:

1. [redacted] me detyrë Përgjegjës i Zyrës të Urbanistikës pasi:

-Ka pranuar dosjet të cilat kanë mungesë të dokumentacionit si më poshtë :

-Dokumentacionin fotografik; këto kryesisht për punimet e padukshme, të cilat janë objekt diskutimi për saktësinë e punimeve, në kundërshtim me Kreun I-rë pikën 8.3 të UKM nr. 2 datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit".

- shkresat për njoftim nga Drejtori i punimeve për mbikëqyrësit të punimeve, për pasaktësitë, mospërputhjet dhe mungesën e të dhënave në projekt. Në kundërshtim me Kreun II-të pika 2.1, të UKM nr. 2 datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit".

-librat të instruktimit për sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë. Në kundërshtim me kreun III-të pika 3, të UKM nr. 2 datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit".

- Regjistrin e kontabilitetit
- Deklaratat teknike të punimeve
- Certifikatat e cilësisë të materialeve e të produkteve të tyre.
- Të gjitha dosjet e prokurimeve janë pranë Zyrës të Arkivës, por janë të pa protokolluara dhe të padorëzuara me proces verbal:

Në kundërshtim me ligjin 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat"

Ka përllogaritur gabim, tarifën në përqindje, për pagesën e kolaudatorëve të kolaudimit të objekteve, paguar më tepër *në shumën 223,549 lekë*, në kundërshtim me pikën b, "Tarifat për Kolaudimin përfundimtar të Ndërtim Montimit" të VKM 444, datë 05.9.1994, "Për tarifat e Studimit, Drejtimit dhe Kolaudimit të Ndërtimit"

2. [redacted] me detyrë Përgjegjës i Zyrës të Taksave pasi :

Në kundërshtim me ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" ndryshuar me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 neni 49 "Shkeljet dhe dënimet për regjistrimin", pika 1, dhe në zbatim të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997, ndryshuar me ligjin nr. 8335, datë 23.04.1998 dhe me pikat 3 e 5 të udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë të Pushtetit Vendor nr. 5, datë 27.01.2003,

- nuk ka realizuar të ardhurat nga taksat e tarifat në shumën 14,025,648 lekë prej të cilave:
- *në 29 raste*, nga biznesi i vogël që s'kanë paguar detyrimet e taksave vendore , në vlerë 1,245,708 lekë
- *në 19 raste*, nga biznesi i madh, që s'kanë paguar detyrimet e taksave vendore, në vlerë 11,066,140 lekë
- për 743 familje, nuk kanë likuiduar taksën e tokës bujqësore me vlerë 625,800 lekë
- për 680 familje, nuk kanë likuiduar taksën e ndërtesës me vlerë 408,000 lekë,
- për 680 familje, nuk kanë likuiduar taksën e pastrimit me vlerë 680,000 lekë.

2[redacted], me detyrë Arkëtare dhe Përgjegjëse e Zyrës të Personelit pasi:

- nuk ka derdhur vlerat monetare të arkëtuara nga taksapaguesit pranë bankës, çdo ditë duke krijuar çdo muaj gjendje arke, që varion nga 460,580 lekë deri në 4,911,286 lekë, duke mos zbatuar limitin e arkës, në kundërshtim me nenet 41, 42 dhe 43 të kreut të V-të, të ligjit 6942, datë 25.12.1984 "Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare".
- me mandat pagesën nr. 9 datën 03.6.2010, për shpërblimin e pensionistëve, 20 muaj më përpara, nuk kanë firmosur listë pagesën (tërhequr lekët**,** në 27 raste, në shumën 91,000 lekë, të ndarë:
- pensionist të moshës 70 deri në 80 vjeç në 22 raste.
- pensionist të moshës 80 deri në 90 vjeç në 5 raste. Vlera monetare 91,000 lekë qëndron pranë arkës e ndarë në 22 zarfe e pa arkëtuar në arkë., veprim ky në kundërshtim me kreun e VII-të neni 33, 34, , kreu i VIII-të nenet 46 dhe 47, "Dokumentimi i punës dhe pagës" të ligjit nr. 6942, datë 25.12.1984.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Piro Imeraj dhe Kujtim Rama. Më tej u shqyrtua nga Kryeauditues i Departamentit Miranda Haxhia, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT